



THIRRJE PUBLIKE:
APLIKIM NË PANAIRIN NDËRKOMBËTAR "GLOBAL ALBANIAN GASTRONOMY FESTIVAL", 2-3 TETOR, BERLIN 2024

Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 2, Tiranë;

Web: www.bujqesia.gov.al

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, fton bizneset që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e bujqësisë, të aplikojnë për pjesëmarrje përmes kësaj thirrje, në panairin Ndërkombëtar "Global Albanian Gastronomy Festival" në datat 2 – 3 Tetor 2024, që zhvillohet në Berlin, Gjermani.

Global Albanian Gastronomy Festival (GAGF), nën moton "*Aty ky tradita takohet me tregtinë*", synon të bashkojë kompani nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë, përfshirë këtu edhe sektorin bujqësor. Në të, pritet të marrin pjesë kompani nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, ku do të prezantojnë produktet dhe shërbimet e tyre, si dhe pritet pjesëmarrja e mbi 5000 vizitorëve, përfshirë këtu dhe diasporën shqiptare.

GAGF do të jetë vendtakimi për rrjetëzimin dhe krijimin e partneriteteve të reja të biznesit, me potencial për rritjen e eksporteve, si dhe promovimin e produkteve dhe shërbimeve të vendeve shqipfolëse.

Grupet e synuara për të marrë pjesë në këtë panair janë kompanitë që synojnë eksportin e prodhimeve bujqësore shqiptare, të cilat operojnë në sektorët e:

- fruta perimeve;
- bimëve aromatike;
- bimëve medicinale;
- prodhimit të pjeve alkolike;
- prodhimit të verës;
- prodhimit të vajit të ullirit;
- prodhimit të nënprodukte të akuakulturës (përveç midhjes);
- prodhimit të agro-përpunimit;

****Produktet e mësipërme duhet të jenë të pajisura me çertifikimin përkatës për eksport;***



Ftojmë të gjitha kompanitë që i përkasin kategorive të sipërpërmendura, të cilat synojnë eksportin e produkteve të tyre, të aplikojnë për pjesëmarrje, duke dërguar me e-mail një prezantim të shkurtër të kompanisë, si dhe kapacitetet eksportuese.

Pjesëmarrja juaj me stenda në këtë panair, mbështetet nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Shpenzimet e tjera, si transport, akomodim etj., do të mbulohen nga vetë pjesëmarrësi.

Afati për aplikim për pjesëmarrje është deri më **16 Gusht 2024**. Aplikimin dhe dokumentat shoqëruese, lutemi t'i përcillni në adresën: info@bujqesia.gov.al

Në vijim, do t'ju informojmë mbi detaje të mëtejshme rreth pjesëmarrjes suaj në këtë panair.